



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



R R E G U L L O R E
P Ë R
T A T I M N Ë P R O N Ë N E P A L U A J T S H M E

Prishtinë, 2014

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, pika c të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/2008), të dispozitave të nenit 9 të Ligjit nr. 03/L - 049, për financat e pushtetit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 27/2008), të nenit 7 të Ligjit nr. 03/L - 2004, për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 88/2010), të dispozitave të nenit 2 të Ligjit nr. 04/ L - 100, për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 2004, për tatimin në pronën e paluajtshme ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 14/2012), të dispozitave të nenit 34, paragrafi 34.1, pika c të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, më 29.09.2014, miratoi këtë

R R E G U L L O R E **P Ë R** **T A T I M N Ë P R O N Ë N E P A L U A J T S H M E**

I. DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Qëllimi

Neni 1

1.1 Në bazë të kësaj rregulloreje caktohet tatimin në pronën e paluajtshme dhe parashtrohen standardet dhe procedurat, të cilat duhet t'i respektojë Komuna gjatë administrimit të këtij tatimi.

1.2 Të hyrat e vjela nga tatimi në pronë, do të derdhën në llogari të Komunës dhe do të përdoren në përputhje me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe Ligjin për financat e pushtetit lokal.

Neni 2

Tatimi në pronë caktohet për tërë pronën e paluajtshme në komunë, me përjashtim të pronës që lirohet nga tatimi, në përputhje me nenin 6 të kësaj rregulloreje.

II. DISPOZITAT E VEÇANTA

Tatimpaguesi

Neni 3

3.1 Personi përgjegjës për pagesën e tatimit në pronë (më tej: *tatimpaguesi*), para së gjithash është pronari i pronës.

3.2 Nëse pronari i pronës nuk mund të përcaktohet ose nuk mund të gjendet, tatimpagues është personi fizik dhe juridik, i cili e shfrytëzon ligjërisht, apo e mban pronën e paluajtshme.

3.3 Nëse pronari ose shfrytëzuesi i ligjshëm i pronës së paluajtshme nuk mund të përcaktohet, apo mund të përcaktohet, por nuk ka qasje ndaj pronës së paluajtshme, tatimpagues do të jetë personi fizik dhe juridik që e shfrytëzon pronën. Vendimi i tillë nuk i jep kurrfarë të drejtash shfrytëzuesit.

Baza e tatimit

Neni 4

4.1 Bazë e tatimit për tatim në pronë do të jetë vlera e pronës në treg, e përcaktuar në pajtim me standardet dhe procedurat e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe aktet nënligjore.

4.2 Vlerë e tregut e cilësdo pronë, për çdo vit tatimor, është vlera e pronës më 31 dhjetor të vitit paraprak.

Shkallët e tatimit

Neni 5

5.1 Kuvendi i Komunës i cakton tarifat tatimore për pronën, në bazë vjetore, në shkallën prej 0.15 % deri 0.17 % të vlerës së pronës në treg.

5.2 Tarifat e tatimit lëvizin brenda kategorive vijuese të pronës:

- a) Pronë e nevojshme për qëllime banimi: prona e paluajtshme, e cila u shërben njerëzëve për nevoja themelore të banimit, ku përfshihen: shtëpitë, banesat dhe ndërtesat e ngjashme0.15 %;
- b) Pronë e banuar: prona e cila shfrytëzohet ose mbahet për banimin e njerëzve, ku përfshihen: toka, garazhet, hapësirat e parkimit ose ndërtesat e tjera të ngjashme jokomerciale.....0.15 %;
- c) Pronë komerciale: prona që shfrytëzohet ose përdoret për qëllime biznesi, për shembull për ndonjë qëllim komercial ose biznesi, për shitje me pakicë, për shërbime rekreacioni, për qëllime artistike ose sportive, për arsim privat ose për qëllime mjekësore private.....0.17 %;
- d) Fusha sportive.....0.17%;
- e) Pronë industriale: prona e cila shfrytëzohet për produkte artikujsh, për prodhim, për punim ose deponim të mallrave, duke përfshirë fabrikat, depot, punëtoritë dhe objektet e tjera të ngjashme.....0.17 %;
- f) Pronë bujqësore: toka dhe ndërtesat, të cilat shfrytëzohen për qëllime bujqësore..... 0.15%

5.3 Tarifat e tatimit të caktuar për pronën në kategoritë 5.2 (c) dhe 5.2 (d), nuk do të jenë më të mëdha se 2.5 herë të lartësisë së tarifës së tatimit për pronën në kategorinë 5.2 (b).

5.4 Madhësia e pronës shprehet në metër katror (m²), e kalkuluar vetëm nga matjet e mureve të jashtme, duke llogaritur edhe metrat katrorë të etazheve (kateve). Për katin nën kulm, sipërfaqja llogaritet për 50% më pak nga sipërfaqja e katit të plotë.

5.5 Pronë e papërfunduar, është prona në ndërtim e sipër, që nuk i plotëson kushtet për shfrytëzim normal dhe që do të vlerësohet dyzet përqind (40%) e vlerës së pronave rezidenciale dhe me normë të tatimit të po këtyre pronave.

5.6 Komuna e Prishtinës ndahet në gjashtë zona tatimore, zona urbane ndahet në katër zona tatimore, prej të cilave zona: I, II, dhe III ndahen në kategorinë e parë dhe të dytë, ndërsa zonat rurale të komunës ndahen në dy zona tatimore: zona: V dhe VI.

5.7 Zonat tatimore të komunës:

5.7.1 Zona e parë

Zona e parë e qytetit përfshinë rrugët: "Ilir Konushevc" me rrugën "Ilaz Agushi", rruga "Ilaz Agushi" me rrugën "Emin Duraku", rruga "Emin Duraku" me rrugën "Zenel Salihu", rruga "Zenel Salihu" me rrugën "Rrustem Hyseni", rruga "Hysen Hyseni" me rrugën "Hamzë Jashari", rruga "Hamzë Jashari" me rrugën "Rexhep Mala", rruga "Rexhep Mala" me rrugën "Eqrem Çabej", rruga "Eqrem Çabej" me bulevardin "Bill Clinton", bulevardi "Bill Clinton" me rrugën "Tirana", rruga "Tirana" me rrugën "Lidhja e Prizrenit", rruga "Lidhja e Prizrenit" me rrugën "Mark Isaku", rruga "Mark Isaku" me rrugën "Vushtrria", rruga "Vushtrria" me rrugën "Iliaz Agushi".

a) Zona e parë - Kategoria e parë:

Zona e parë kategoria e parë përfshinë rrugët: "UÇK", "Migjeni", "Fehmi Agani", bulevardi "Nënë Tereza", "Fazli Grajqevci", "Bedri Pejani", "Andrea Gropa", "Hajdar Dushi", "Rexhep Luci", "Luan Haradinaj", "Garibaldi", "Kosta Novaković", "Pashko Vasa", "Robert Doll" "Mujo Ulqinaku", "Radovan Zogović", "Mbreti Zogu I", "Perandori Justinian", "Sejdi Kryeziu", "Jonuz Zejnullahu", "Johan V. Han", "Sylejman Vokshi", "2 Korriku", "Qamil Hoxha", "Tringë Smaili", "Ilir Konushevc", "Mark Isak", "Iliaz Agushi", "Emin Duraku", "Rrustem Hyseni", "Hamzë Jashari", "A. Karl Gega", "Rexhep Mala", "Anton Çetta", "Ali Pashë Tepelena", "Sami Peja", "Halil Alidemaj", "Gustav Majer", "Shaban Polluzha", "Afrim Vitija", "Svetozar Marković", "Zeki Shulemaja", "Mustafa Kruja", "Hamdi Mramori", "Ibrahim Lytftiu", "Taip Krasniqi", "Mehmet Kaçurri", "Vasil Andoni", "Xhemail Prishtina", "Ylfete Humolli", "Meto Bajraktari", "Çajupi", "Perandori Dioklecian", "Josip Relja", "Tirana", "Enver Zymberi" dhe "Kosta Novaković".

Kategorisë së parë i përkasin edhe:

rruga "Agim Ramadani", nga udhëkryqi i rrugës "Ylfete Humolli" deri në prerjen e rrugës "Eqrem Çabej", rruga "Bill Clinton", nga këndi i rrugës "B.N.Tereza" deri te rruga "Tirana", rruga "Eqrem Çabej", nga këndi rrugëve "B.Nënë Tereza" deri te këndi i rrugës "Rexhep Mala", rruga "Lidhja e Prizrenit", nga këndi i rrugës "UÇK" deri te rruga "Vushtrria", rruga "Vushtrria", nga këndi i rrugës "Ilir Konushevc" deri te rruga "Mark Isaku", rruga "Zenel Salihu", nga këndi i rrugës "Agim Ramadani" deri te rruga "Rrustem Hyseni", rruga "Adrian Krasniqi", nga këndi i rrugës "Agim Ramadani" deri te rruga "Hamzë Jashari", rruga "Bajram

Kelmendi", nga kendi i rrugës "Agim Ramadani" deri te rruga "Rrustem Hyseni", rruga "Mustafa Kruja", nga këndi i rrugës "Agim Ramadani" deri te rruga "Hamzë Jashari", rruga "Rrustem Statovci", nga këndi i rrugës "Agim Ramadani" deri te rruga "Hamzë Jashari", rruga "Murat Mehmeti", nga këndi i rrugës "Mark Isaku" deri te rruga "Vushtrria", rruga "Kajtaç Ramadani", nga këndi i rrugës "UÇK" deri te rruga "Levizja e Prizrenit", rruga "Ilir Konushevci", nga këndi i rrugës "UÇK" deri te rruga "Ilijaz Agushi".

b) Të gjitha pronat që gjenden në ngastrat që i përkasin rrugëve të mbyllura i takojnë kategorisë së dytë.

5.7.2 Zona e dytë

Zona e dytë e qytetit përfshinë: rruga "Fehmi Lladrovci" me rrugën "Muharrem Fejza", rruga "Muharrem Fejza" deri te rreth-rrotullimi i "Rrugës B", përgjatë "Rrugës B" deri te rr. "Rrahim Beqiri", rruga "Rrahim Beqiri" deri te rruga "Xheladin Hana", rruga "Xheladin Hana" deri kryqëzimi i rrugës "Isa Kastrati", rruga "Isa Kastrati" deri te rruga "Dëshmoret e Marecit", rruga "Dëshmorët e Marecit" deri te rruga "1 Tetori", rruga "1 Tetori" deri te rruga "Nazim Gafurri", rruga "Nazim Gafurri" deri te rruga "Xhavit Ahmeti", rruga "Xhavit Ahmeti" deri te kryqëzimi i rrugës "Demë Ahmeti", rruga "Demë Ahmeti" deri te rruga "Rasim Kiqina", rruga "Rasim Kiqina" deri te rruga "Azem Bejta", rruga "Azem Bejta" deri te rruga "Haxhi Zeka", rruga "Haxhi Zeka" deri te rruga "Bedri Bajrami", rruga "Bedri Bajrami" deri te rruga "Bajram Bahtiri", rruga "Bajram Bahtiri" duke u kufizuar me rrugën "Hekurudha" deri në kufi me Tjegulloren, duke përfshirë Tjegulloren deri te rruga "Vushtrria", rruga "Vushtrria" deri te rruga "Azem Jashanica", rruga "Azem Jashanica" deri te rruga "Ismail Qemali", rruga "Ismail Qemali" deri te rruga "Ahmet Krasniqi", rruga "Ahmet Krasniqi" duke e përkufizuar rruga magjistrale Prishtinë - Mitrovicë, dhe Prishtinë - Shkup, deri te rreth-rrotullimi "Veternik", dhe nga rreth-rrotullimi "Veternik" deri te rruga "Fehmi Lladrovci".

a) Zona e dytë - Kategoria e parë

Në zonën e dytë, kategoria e parë përfshinë rrugët: "Feriz Blakqori", "Pjetër Bogdani", "Lidhja e Lezhës", "Murat Mehmeti", "Maliq Pashë Gjinolli", "Mbreti Bardhyl", "Llapi", "Zija Prishtina", "Antigona Fazliu", "Enver Berisha", "Hoxhë Kadri Prishtina", "Mustafë Veselaj", "Zeqir Bajrami", "Elvia Çelebia", "Agim Bajrami", "Presheva", "Ibrahim Krasniqi", "Abedin Rexha", "Bedri Bajrami", "Ali Hadri", "Nazim Gafurri", "Fadil Hoxha", "Shkodra", "Xheladin Kurbaliu", "Fan Noli", "Rasim Kiqina", "Karadaku", "Igballe Prishtina", "Mehmet Akif Ersoy", "Naser Hajrizi", "Abdyl Ramaj", "Visar Dodoni", "Ukë Sadiku", "Halim Orana", "Ymer Lutfi Paqarizi", "Kuvendi i Bujanit", "Rexhep Shema", "Ismet Jashari - Kumanova", "Nikollë Teslla", "Hoxhë Hasan Tasini", "Hil Mosi", "Kongresi i Manastirit", "Hysni Curri", "Afrim Loxha", "Ismail Dumoshi", "Ibrahim Banushi", "Bajram Kelmendi", "Xhavit Mitrovica", "Mustafa Hoxha", "Isa Boletini", "Selman Riza", "Edmond Hoxha", "Xhemë Gostivari", "Shaip Kamberi", "Ymer Berisha", "Xhemail Berisha", "Emrush Miftari", "Hamdi Gashi", "1 Tetori", "Sali Nivica", "Bedri Shala", "Pren Doqi", "Tivari", "Shaip Spahia", "Sokol Sopi", "Latif Berisha", "Kaçaniku", "Abdyl Frashëri", "Ali Kelmendi", "Hamzë Jashari", "Nak Berisha", "Rrahim Beqiri", "Lordi Bajron", "Norbert Nokli", "Viktor Efendiu", "Mensur Zymberaj", "Salih Abazi", "Hilmi Rakovica", "Thimi Mitko", "Gjin Gazulli", "Hajrullah Abdullahu", "Ganimete Tërbeshi", "Florim Imeri", "Mitrovica", "Eqrem Çabej", "Enver Maloku", "Hyzri Talla", "Xheladin Rekalii", "Fehmi Lladrovci", "Major Mehmet Bushi", "Fatos Limani", "Smajl

Hajdaraj", "Hakif Zejnullahu", "Muje Krasniqi", "Henry Dynam", "28 Nëntori", "Imzot Nikë Prela", "Mark Dizdar", "Motrat Qiriaz", "Selami Pulaha", "Musine Kokollari", "Ilaz Kodra", "Idriz Gjilani", "B. Dëshmorët e Kombit", "Xhemail Mustafa", "Rexhep Mitrovica", "Sadik Zeneli", "Lekë Dukagjini", "Lazar Vučković", "Mustafa Venhari", "Ymer Alishani", "Zagrebi", "Ahmet Krasniqi", "Bajram Curri", "Eduard Lir", "24 Maji", "Selim Berisha", "Metush Krasniqi", "Bekim Berisha", "Johan V. Göte", "Ismail Qemali", "Azem Jashanica", "Hasan Mekuli", rruga "Bajram Bahtiri", nga fillimi i rrugës "Irir Konushevc" deri te këndi i rrugës "Bedri Bajrami", rruga "Muharrem Fejza", nga fillimi i rrugës "Fehmi Lladrovci" deri te "Rruga B".

b) Zona e dytë - kategoria e dytë

Zona e dytë, kategoria e dytë përfshin rrugët: "Lazgush Poradeci", "Sokol Dobroshti", "Mehmet Ali Vrioni", "Mehmet Pashë Deralla", "Shefqet Zeka", "Gjergj Fishta", "Adem Gllavica", "Gasber Gjini", "Mirko Gashi", "Henrik Bariq", "Ingrid Cara", "Esad Mekuli", "Haqif Tetova", "Hamdi Beha", "Remzi Adem", "Sadik Rama", "Mirvete Maksutaj", "Haki Taha", "Hysen Prishtina", "Naim Gashi", "Onufri", "Shefqet Kapetani", "Dimitrie Tucović", "Ymer Prizreni", "Rifat Berisha", "Asim Luzha", "Luigj Gurakuqi", "Shyt Mareci", "Sefë Kosharja", "Vejsel Pagarusha", "Bardhosh Gërvalla", "Afrim Zhitija", "Armend Daci", "Dervish Rozhaja", "Ferat Draga", "Qamil Bala", "Mehmet Gradica", "Rifat Burgjeviq", "Ekrem Rexha", "Mithat Frashëri", rruga "Haxhi Zeka", nga këndi i rrugës "Nazim Gafurri" deri te rruga "Lidhja e Prizrenit".

Zona e dytë e qytetit përbëhet edhe nga të gjitha pjesët që nuk janë përfshirë në zonën e parë dhe të dytë, e që janë përfshirë në planin e përpunimit urban të qytetit.

5.7.3 Zona e tretë

a) Zona e tretë - kategoria e parë

Zona e tretë, kategoria e parë përfshinë rrugët: "Stefan Makronjac", "Dervish Shaqa", "Ernes Zariqi", "Mehmet Beci", "Ohri", "Ali Pashë Gucia", "Leka i Madh", "Xhavit Ahmeti", "Durrësi", "Jan Kokozeli", "Kolonel Fuad Dibra", "Ndre Mjeda", "Skënder Anamali", "Xhelal Preveza", "Pashtriku", "Mihal Grameno", "Sali Budka", "Avni Rrustemi", "Adem Gashi", "Butrinti", "Jeronim de Rada", "Martin Camaj", "Mbretëresha Teuta", "Dr. Lec Gradica", "Dëshmorët e Marecit", "Xheladin Hana", "Ndue Përllëshi", "Shaqir Igrishta", "Theodor Muzaku", "Ahmet Korenica", "Nazim Berati", "Ymer Elshani", "Muhamet Qami", "Azem Bejta", "Ahmet Gashi", "Malush Kosova", "Holger Peterson", "Behar Begolli", "Shkupi", "Rexhep Krasniqi", "Marin Barleti", "Mesih Prishtinasi", "Selam Musai", "Bajram Shabani", "Dervish Hima", "Tahir Zajmi", "Shefqet Shkupi", "Papa Kristo Negovani", "Lidhja e Pejës", "Afrim Gashi", "Toni Bler", "Fadil Bala", "Selamn Lajqi", "Ismet Bicaj", "Halim Spahija", "Qorr Ilazi", "Dëshmorët e Sharbanit", "Stambolli", "Gjergj Balsha", rruga Prishtinë - Mitrovicë, rruga Prishtinë - Ferizaj, "Murat Xhakja", "Xhelal Hajda", "Nasiet Selimi", "Jashar Erebara", "Hasan Remniku", "12 Qershori", "Afërdita", "Dëshmorët e Ponushevcit", "Gjilani", "Gucia", "Liria", "Lugmiri", "Manastiri", "Nebih Gashi", "Papa Gjon Pali II", "Qëndresa", "Ramiz Cërrnica", "Rrotat e Prizrenit", "Selman Laiqi", "Struga", "Rruga A", "Rruga B", "Ruga C", "Rruga D".

b) Zona e tretë - kategoria e dytë

Zona e tretë, kategoria e dytë përfshinë të gjitha rrugët dytësore që kanë qasje në rrugën parësore, rruga: "Trepça", "Raif Halimi", "Nijazi Azemi", "Mehmet Konjuhi", "Sylë Zarbinca", "Sharri", "Abdyl Lahu", "Azem Orana", "Katarina Josipi", "Pal Palucaj", "Rexhep Elmazi", "Jakov Xoxa", "Kerem Leëton", "Prekazi", "Lot Vaku", "Beqir Kastrati", "Abdullah Presheva", "Ukshin Kovaqica", "Vojislav Dançetoviq", "Ibrahim Oruqi", "Skënder Çeku", "Ahmet Hagjija", "Tahir Uka", "Vëllezërit Topulli", "Fatime Hetemi", "Hasan Nahi", "Agim Qela", "Ismet Allani", "Shandor Petëfi", "Tahir Meha", "Mbreti Longar I", "Nikoll Ivanaj", "Fehmi Krasniqi", "Bedri Sokoli", "Ulqini", "Kolë Parubi", "Shukë Haxhia", "Ramë Bllaca", "Agron Rrahmani", "Idriz Shahmani", "Peshteri", "Ahmet Kaçiku", "Hafëz Ali Korça", "Azem Babiqi", "Idriz Ajet Gashi", "Haki Pavata", "Aleks Buda", "Beqir Musliu", "Ismail Ismili", "Sylë Hoda", "Josip Bageri", "Esat Berisha", "Nesret Krasniqi", "Afrim Abazi", "Dervish Cara", "Basri Canolli", "Shaip Mustafa", "Vëllezërit Rama", "Nail Hyseni", "Ferid Curri", "Nazim Hikmet", "Dil Mramori", "Don Shtjefën Kurti", "Ukshin Hoti", "Ujëmani", "Selim Bislimi", "Remzi Salihu", "Osman Dumoshi", "Okarina", "Nekibe Kelmendi", "Martin Camaj", "Mahmut Bakalli", "Labëria", "Korabi", "Hysen Tërpeza", "Hyrije Hana", "Hodo Bej Sokoli", "Hasi", "Atë Zef Pëllumbi", "Ardhëmëia", "Dibra".

Zona e tretë e qytetit përbëhet edhe nga të gjitha pjesët që nuk janë përfshirë në zonën e parë dhe të dytë, e që janë përfshirë në planin e përpunimit urban të qytetit.

5.7.4 Zona e katërt

Zona e katërt e qytetit fillon me kufizim të hekurrudhës afër Xhamisë së Llapit, vazhdon përgjatë hekurrudhës deri te Tunelli, në kufi me fshatin Llukar, dhe vazhdon deri në kufi me fshatin Bërnice e Eperme, vazhdon deri në kufirin e Bërnices së Poshtme, deri te Varrezat e qytetit, dhe vazhdon deri te rruga "Plava", përgjatë Tjegullorës dhe përfundon afër Xhamisë së Llapit. Kësaj zone i takon edhe rruga "7 Shtatori".

5.7.5 Zona e pestë

Zona e pestë përfshinë fshatrat: Hajvali, Barilevë, Besi, Bardhosh, Bërnice e Poshtme, Bërnice e Eperme, Qagllavicë, Drenoc, Lebanë, Llukar, Makoc, Shkabaj, Prugoc, Trudë, Vranidoll dhe Kolovicë.

5.7.6 Zona e gjashtë, përfshinë fshatrat: Hajkobilë, Ballaban, Dabishec, Gllogovicë, Grashticë, Keqekollë, Koliq, Marec, Mramor, Nishec, Katuni i Ri, Prapashticë, Radashec, Rimanishtë, Sharban, Shashkoc, Siqevë, Slivovë, Tenezhdol, Zllatar, Butovc.

5.8 Vlera e pronës

Vlera e pronave përcaktohet sipas zonave të vlerësimit dhe janë shprehur në € për 1 m², si vijon:

5.8.1 Zona I

a) Kategoria e parë:

Vlerat e pronave bujqësore të braktisura, do të caktohen në bazë të analizave të bëra për pronat përkatëse, me normën përkatëse prej 0.15 %.

Lirimi nga tatimi në pronën e paluajtshme

Neni 6

6.1 Institucionet dhe organizatat e cekura më poshtë, do të lirohen nga tatimi për pronën që e posedojnë ose e shfrytëzojnë:

- a) Institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës;
- b) Kombet e Bashkuara dhe çdo organ i saj, agjencitë e specializuara të Kombeve të Bashkuar dhe të Bashkimit Evropian;
- c) Forcat shumëkombëshe në Republikën e Kosovës (KFOR-i, ICO-ja dhe EULEX-i);
- d) Përfaqësitë diplomatike dhe konsullatat e akredituara në shtetin e Kosovës, rregullimi i të cilave bëhet me marrëveshje të reciprocitetit mes shteteve, zyrat e huaja të ndërlidhjes, agjencitë qeveritare, organizatat ndërqeveritare ose agjencitë e huaja donatore që ofrojnë ndihmë humanitare, punë rindërtimi, administrim civil ose ndihmë teknike në Kosovë;
- e) Organizatat joqeveritare me status të përfitimit të ndërsjellë publik, në përputhje me Ligjin për asocimin e organizatave joqeveritare në Kosovë;
- f) Institucionet fetare, të përcaktuara me Ligj, prona e të cilave mbahet dhe shfrytëzohet vetëm për qëllime fetare dhe
- g) Objektet, të cilat sipas ligjit janë shpallur monumente të mbrojtura kulturore e historike.

6.2. Lirimi nga tatimi, sipas nenit 6.1, nuk vlen kur:

- a) prona shfrytëzohet ose mbahet për shfrytëzimin e veprimtarisë komerciale dhe për krijimin e të ardhurave ose
- b) prona e zotëruar ose e shfrytëzuar nga një organizatë joqeveritare me status të përfitimit publik, nuk shfrytëzohet ekskluzivisht për qëllime të përfitimit publik.

Zbritja lidhur me vendbanimin kryesor

Neni 7

Personit fizik, i cili më 1 mars ose para 1 marsit të një periudhe tatimore, vendos se prona ose njësia e banimit, i shërben si vend kryesor për banim, i lejohet zbritja prej 10.000 € nga vlera e tatueshme e pronës.

Informacioni për regjistrimin e pronës

Neni 8

8.1 Të gjithë personat, të cilët kanë ose banojnë në një pronë të paluajtshme, janë të obliguar që ta regjistrojnë atë pronë në bazë të të dhënave për tatimin komunal të pronës, dhe t'i ofrojnë Komunës informacionin lidhur me pronën e paluajtshme, e cila i nënshtrohet regjistrimit më 1 mars ose para 1 marsit të çdo periudhe tatimore.

8.2 Të gjithë personat, të cilët kanë, shfrytëzojnë ose marrin një pronë të paluajtshme, përveç rasteve të caktuara në nenin 8.3, duhet t'i lejojnë zyrtarët e autorizuar që përfaqësojnë autoritetet komunale të tatimit, të hyjnë në tokën dhe në ndërtesat e tyre gjatë orëve të ditës për t'i mbledhur të dhënat lidhur me vlerën e pronës.

8.3 Komuna mund të kërkojë nga UNMIK-u, KFOR-i, ICO-ja, EULEKS - i ose zyrtarët jashtë të ndërlidhjes që posedojnë ose shfrytëzojnë pronë të paluajtshme, të sigurojnë të dhëna mbi atë pronë për bazën e të dhënave tatimore mbi pronën komunale. Sigurimi i një informacioni të tillë duhet të bëhet në baza vullnetare dhe nuk cenon privilegjet dhe imunitetin që mund të vlejë në këto raste.

Përgjegjësitë komunale

Neni 9

9.1 Komuna, është përgjegjëse për funksionet e mëposhtme në administrimin e tatimit në pronë, siç është:

- a) Menaxhimi i informatave tatimore mbi pronën;
- b) Vlerësimi i pronës;
- c) Përgatitja dhe lëshimi i faturave të tatimit;
- d) Vjelja dhe vjelja e detyruar e tatimit në pronë dhe
- e) Ankesat administrative.

9.2 Funksioni i vjeljes së tatimit bëhet nga Drejtoria e Financave dhe e Pronës. Funksioni administrativ i ankesave duhet t'i caktohet Bordit komunal për ankesa lidhur me tatimin në pronën e paluajtshme, që duhet të themelohet nga Kryetari i Komunës, e që do të veprojë në përputhje me procedurën e parashtruar për këtë qëllim, sipas udhëzimit administrativ të nxjerrë nga ministri i Ministrisë së Financave.

Informacioni lidhur me tatimin në pronë

Neni 10

10.1 Drejtoria duhet të themelojë dhe të mbajë një bazë të dhënash lidhur me tatimin në pronë, por pa u kufizuar vetëm në tatimin në pronë, duke përfshirë adresat e pronës, adresat e poseduesve dhe të shfrytëzuesve të pronës, të dhënat mbi tokën dhe ndërtesat, vlerat e pronës, faturat e pronës dhe shënimet mbi pagesat e tatimit.

10.2 Baza e të dhënave për pronën duhet të mbështetet në regjistrin e të drejtave mbi pronën dhe kadastrën e tokës. Organi përgjegjës për punët e kadastrit do të sigurojë

bazën e të dhënave për tatimin në pronë dhe informacionin e nevojshëm nga regjistri mbi të drejtën në pronën e paluajtshme. Organi duhet të sigurojë për Agjencinë Kadastrale të Kosovës, të dhënat nga baza e të dhënave mbi pronën, në intervale kohore që do të caktohen nga Agjencia Kadastrale e Kosovës.

10.3 Informacioni mbi regjistrimet e pronës në bazë të të dhënave përkitazi me tatimin në pronën e paluajtshme, duhet të jetë në dispozicion të publikut.

Vlerësimi i pronës

Neni 11

11.1 Vlerësimi i pronës së paluajtshme nga ana e Komunës, bazohet në Udhëzimin administrativ përkatës që e nxjerr Ministria e Financave, me të cilin parashtrohen standardet unike të vlerësimit, sipas të cilave Komuna e vendos vlerën e pronës në treg. Standardet përfshijnë variabellet relevante të vlerësimit, siç janë vlera në pajtim me kontratën e shitjes së pronës së paluajtshme, e vlerësuar nga organi kompetent, të ardhurat të cilat krijohen nga prona, shpenzimet e ndërtimit, vendi, madhësia dhe gjendja e pronës. Standardet do të bazohen në një vlerësim të përgjithshëm, pos rasteve kur prona shfrytëzohet për qëllime të veçanta ose për pronë unike”.

11.2 Drejtoria e përcakton vlerën e tregut të pronës që është nën juridiksionin e saj, në pajtim me standardet e përcaktuara sipas dispozitave të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme dhe akteve nënligjore.

11.3 Drejtoria e shqyrton dhe e përcjell vlerën e tregut të çdo prone që është në juridiksionin e saj, për çdo tri ose pesë vjet.

11.4 Drejtoria e rivlerëson pronën çdo vjet, nëse janë kryer ndërtime të reja ose janë bërë përmirësime thelbësore në pronë dhe nëse ekziston ndonjë ndryshim në shfrytëzimin e pronës.

11.5 Pronari ose shfrytëzuesi i pronës mund të kërkojë nga Komuna rivlerësimin e pronës, kur prona ka pësuar dëm, për të cilin nuk është shkaktar ose përgjegjës pronari apo shfrytëzuesi, siç janë dëmet që mund të ndodhin nga thatësira, vërshimi, zjarri, tërmeti, lufta ose fatkeqësitë e tjera.

Faturat e tatimit

Neni 12

12.1 Varësisht nga kushtet e parashtruara në këtë rregullore, Drejtoria do të autorizohet për të lëshuar fatura të tatimit vjetor në pronë.

12.2 Lëshimi i faturave të tatimit në pronën bëhet para 31 marsit të secilit vit.

12.3 Fatura e tatimit në pronë duhet të përfshijë informacionin e mëposhtëm:

- a) Identifikuesin e bazës së të dhënave për tatimin në pronë;
- b) Emrin e tatimpaguesit;
- c) Adresën e pronës;
- d) Adresën për dërgimin e faturës së tatimit, nëse është e ndryshme nga adresa e pronës;
- e) Vlerën e vlerësuar të pronës;
- f) Tarifën e tatimit;

- g) Detyrimin total të tatimit;
- h) Datën kur duhet të bëhet pagesa e tatimit;
- i) Procedurën për pagesën e faturës së tatimit dhe
- j) Shqyrtimin dhe të drejtën për t'u ankuar, së bashku me procedurat e nevojshme.

Pagimi i tatimit

Neni 13

13.1 Për vitin tatimor dhe vitet vijuese, tatimi i caktuar me anë të kësaj rregulloreje duhet të paguhet në dy këste të barabarta, më 30 qershor dhe më 31 dhjetor të vitit tatimor ose përpara.

13.2 Pagesa e tatimit në pronë duhet të bëhet në tërësi nëse kërkohet të bëhet transfer i pronës apo ndërrim i pronarit, qoftë ai tatimpagues i ligjshëm, shfrytëzues i ligjshëm apo shfrytëzues tjetër.

13.3 Pagesa e tatimit për pronat e ish-ndërmarrjeve shoqërore që janë privatizuar, duhet të bëhet sipas llogaritjeve në përputhje me Ligjin për tatimin në pronën e paluajtshme, duke përfshirë këtu edhe llogaritjen e dënimit dhe kamatës sipas dispozitave të nenit 18 dhe 19 të Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme.

Shtyerja e tatimit

Neni 14

14.1 Drejtoria, në rrethana të veçanta, të cilat do të shkaktonin vështirësi të tepruara për tatimpaguesin, mund t'i lejojë tatimpaguesit që ta shtyjë pagimin e tatimit, me kusht që shtyrja të vlejë për një faturë të caktuar të tatimit, e cila kufizohet për një afat kohor që nuk i tejkalon dy vjet. Tatimpaguesit të cilët kërkojnë lehtësim sipas këtij neni, duhet të paraqesin dëshmi thelbësore, të cilat mbështesin kërkesat e tyre për vështirësitë e tyre të paligjshme.

14.2 Procedurat për shtyrjen e tatimit, duke përfshirë edhe natyrën e dëshmisë që duhet të paraqitet për këtë qëllim, duhet të përcaktohen me anë të një udhëzimi administrativ, i cili duhet të jetë në harmoni me udhëzimin e nxjerrë nga Ministria e Financave.

E drejta e pengmarrjes për tatim

Neni 15

15.1 Sipas kësaj rregulloreje, çdo mospagim i tatimit të pronës përbën të drejtën e pengmarrjes në dobi të Komunës.

15.2 Nëse Komuna e regjistron të drejtën e pengut në regjistrin e të drejtave mbi pronën e paluajtshme, një e drejtë e tillë e pengut do të ketë përparësi mbi të gjitha të drejtat e tjera të pengmarrjes të dorëzuara më vonë. Pas pagesës së plotë të borxhit të tatimit, e drejta e pengut do të përfundojë.

15.3 Personi, pasuria e të cilit i nënshtrohet të drejtës së pengut, mund të ankohet në Komunë për t'ua liruar nga e drejta e pengut, në rast se pohohet se është bërë gabim me rastin e parashtrimit të kërkesës për të drejtën e pengut.

Vjelja e detyruar e tatimit

Neni 16

16.1 Drejtoria duhet të emërojë tatimvjelësit për të zbatuar vjeljen e tatimit në pronë.

16.2 Nëse tatimpaguesi nuk e kryen pagesën e duhur, tatimvjelësit mund të lëshojnë vërejtjen e fundit me shkrim, me anë të së cilës shprehet qëllimi për të konfiskuar pronën personale, e cila i takon personit të tillë. Vërejtja e tillë duhet:

- a) t'i dërgohet tatimpaguesit (dhe do të konsiderohet e vlefshme madje edhe në rastet kur tatimpaguesi refuzon për të pranuar dokumentin);
- b) të shpallet në vendbanimin apo lokalet e punës së tatimpaguesit ose
- c) të dërgohet me postë në adresën e fundit të ditur të tatimpaguesit.

16.3 Nëse tatimpaguesi nuk e paguan shumën e plotë të tatimit të papaguar me dënimet dhe kamatat brenda 10 ditësh pas dorëzimit të vërejtjes përfundimtare për tatimpaguesin, do të jenë të ligjshme për tatimvjelësit që:

- a) t'ia lëshojnë njoftimin mbi konfiskimin personit që ka detyrim t'ia paguajë tatimpaguesit pagë, qira ose borxh tjetër;
- b) t'ia lëshojë një njoftim për konfiskim bankës ose palës tjetër të tretë lidhur me pasurinë e tatimpaguesit që është në posedimin e tij;
- c) t'ia përfundojë shërbimet komunale lidhur me pronën e tatimpaguesit dhe
- d) të konfiskoje dhe të shesë pronën personale të tatimpaguesit.

16.4 Nga konfiskimi lirohen: ndihmat për fëmijë dhe ndihmat sociale, veshmbathja themelore, ushqimi themelor, orënditë themelore, gjërat themelore personale (duke përjashtuar gjërat luksoze), mjetet e punës së tatimpaguesit.

Humbja e së drejtës në pronë

Neni 17

17.1 Nëse edhe pas dy vjetësh nga njoftimi përfundimtar i pagesës së tatimit borxhi i tatimpaguesit nuk është paguar, atëherë Drejtoria mund t'ua dërgojë një njoftim për konfiskimin e pronës së paluajtshme të gjithë personave që janë të interesuar për atë pronë.

17.2 Nëse pagesa nuk është bërë brenda 30 ditësh nga data kur njoftimi mbi konfiskimin e pronës i është dërguar tatimpaguesit, Komuna mund ta shesë pronën, ose një pjesë të

pronës në një ankand publik, në pajtim me rregullat dhe procedurat që do të përcaktohen me një udhëzim administrativ të lëshuar nga Ministria e Financave.

17.3 Tatimpaguesi, i cili nuk e ka paguar tatimin dhe nuk është pronar i pronës që i nënshtrohet procedurës së konfiskimit, mund të mos e fitojë të drejtën e pronësisë mbi këtë pronë përmes ankandit publik. E njëjta vlen për bashkëshortin e tatimpaguesit dhe vartësit e tij që kanë lidhje farefisnie të shkallës së parë.

17.4 Pas përfundimit të shitjes, në pajtim me nenin 17.2, dhe pasi ofertuesi më i lartë të ketë paguar shumën e plotë të ofertës:

- a) pagesa duhet të depozitohet në një llogari të besuar pengmbajtëse,
- b) gjykata e lëshon urdhrin, me të cilin i jepet e drejta e pronësisë ofertuesit më të lartë pas gjashtë muajve të lëshimit të urdhrin. Vendimi i tillë hyn në fuqi menjëherë, pos nëse e drejta e riblerjes, sipas nenit 17. 4 (c), është ushtruar me sukses, me ç'rast pagesa e bërë për atë shitje nga ofertuesi më i lartë do të kompensohet pa vonesë dhe
- c) tatimpaguesi, i cili nuk e ka paguar tatimin, e ka të drejtën absolute të shlyerjes së detyrimit në pronën e paluajshme përkatëse për një periudhë gjashtëmuajore, pas pagesës së të gjitha borxheve të papaguara të tatimit. E drejta e shlyerjes do të kufizohet vetëm për pronarin ose tatimpaguesin, i cili nuk e ka kryer pagesën. Kjo e drejtë e shlyerjes së detyrimit të tatimpaguesit, ka të bëjë vetëm me tatimpaguesin i cili nuk e ka bërë pagesën. Ushtrimi i së drejtës së shlyerjes së pagesës së tatimpaguesit, nuk i jep atij kurrfarë të drejtash sa i përket pronës plotësuese që ka ekzistuar para konfiskimit.

17.5 Prona e shitur në ankand publik, sipas kësaj rregulloreje, do të jetë e lirë dhe e pastruar nga detyrimet tatimore pronësore të përparshme, madje edhe nëse Komuna nuk e merr shumën e plotë të tatimit të papaguar për shkak të ankandit publik.

17.6 Prona e nevojshme për banim, siç është përcaktuar në nenin 5.2 (a), nuk mund të shitet në ankand publik apo në ndonjë formë tjetër të konfiskuar pa dashje.

Dënimet

Neni 18

18.1 Secilit tatimpagues, i cili nuk bën kërkesë për regjistrim të pronës së paluajshme, ose nuk i siguron Komunës informacionin për tatimin në pronë, në pajtim me nenin 8.1, do t'i dërgohet një vërejtje përfundimtare dhe nëse ai nuk i përmbahet brenda 60 ditësh pas dërgimit të njoftimit, atij do t'i merret e drejta për të ushtruar ankesë lidhur me tatimin.

18.2 Secili person, i cili refuzon të drejtën për inspektim, në pajtim me nenin 8.2, lejon inspektimin në afat prej 60 ditësh nga refuzimi i parë, ose e humb të drejtën për të ushtruar ankesë kundër tatimit.

18.3 Secili tatimpagues, i cili nuk e paguan tatimin në pronë në datën ose para datës së përcaktuar për pagesë, do t'i shtrohet dënimet në një shumë të hollash që është e barabartë me 5% të obligimit tatimor.

18.4 Secili tatimpagues, i cili nuk e paguan tatimin në pronën brenda 60 ditësh pas ditës së fundit të përcaktuar për pagesë, do t'i nënshtrohet një dënimi plotësues në një shumë të hollash që është e barabartë me deri në 10% të obligimit tatimor.

Kamata

Neni 19

Kamata do të llogaritet në baza mujore nga data kur duhet të paguhet tatimi deri në datën kur paguhet tatimi.

Ankesat administrative lidhur me faturat e tatimit në pronën e paluajtshme

Neni 20

20.1 Tatimpaguesi, i cili nuk pajtohet me vendimin e lëshuar nga Bordi komunal, mund të ushtrojë ankesë brenda tridhjetë (30) ditëve nga dita e pranimit të Vendimit nga Bordi Komunal në Divizionin Fiskal të Departamentit për Çështje Administrative të Gjykatës Themelore të Prishtinës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

20.2 Në procedurën e ankesave, për çështje që nuk janë paraparë në këtë rregullore, gjen zbatim Ligji për administratën tatimore në fuqi.

Autorizimi për lëshimin e faturave të tatimit në pronën e paluajtshme

Neni 21

21.1 Drejtoria duhet të ketë autorizim valid nga Ministria e Financave për lëshimin e faturave të tatimit, me qëllim të lëshimit të faturave të tatimit dhe vjeljes së tatimit në pronë në përputhje me këtë rregullore.

21.2 Për të marrë autorizimin e tillë, Komuna duhet të dëshmojë para Ministrisë së Financave, se ajo:

- a) i ka identifikuar dhe regjistruar karakteristikat fizike të pronës së tatueshme me pronën e cila lirohet nga tatimi,
- b) ka themeluar një bazë të të dhënave tatimore mbi pronën,
- c) ka zbatuar kriteret e vlerësimit, në përputhje me kriteret e përcaktuara me nenin 12 të kësaj rregulloreje,
- d) ka caktuar tarifat tatimore mbi pronën, në pajtim me këtë rregullore dhe
- e) ka treguar aftësinë administrative për të kryer menaxhimin e informimit mbi pronën, vlerësimin e pronës, faturimin, vjeljen, vjeljen e dhunshme dhe ankesat administrative.

21.3 Ministria e Financave do t'i bëjë inspektim vjetor Komunës. Inspektimi i tillë duhet të garantojë se janë duke u zbatuar standardet e parapara të vlerësimit, se baza e të dhënave tatimore mbi pronën mirëmbahet në mënyrën e duhur, se procedurat e vjeljes

së dhunshme zbatohen në mënyrë adekuate dhe se Komuna vepron në përputhje me këtë rregullore.

21.4 Nëse inspektimi i kryer në pajtim me nenin 21.5 vërteton se Komuna nuk i është përmbajtur materialisht kësaj rregulloreje, Ministria e Financave duhet t'i bëjë vërejtje Komunës, ku konstatohet natyra e mospërputhjes, si dhe veprimi i kërkuar për respektimin e kësaj rregulloreje.

21.5 Ministria e Financave mund t'i anulojë autorizimin e lëshuar Komunës, në rast se nuk ndërmerr veprimet e duhura lidhur me respektimin e kësaj rregulloreje, brenda 90 ditësh nga pranimi i vërejtjes së tillë.

Neni 22

Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë rregullore, gjen zbatim Ligji për tatimin në pronën e paluajtshme, Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për tatimin në pronën e paluajtshme, si dhe aktet tjera nënligjore që rregullojnë tatimin në pronën e paluajtshme.

III. DISPOZITAT SHFUQIZUESE DHE TË HYRJES NË FUQI

Neni 23

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulloreje, pushon të vlejë Rregullorja për tatim në pronën e paluajtshme, 01 nr. 110 - 2250, të dt. 5.10.2011 dhe Vendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullorës për tatimin në pronën e paluajtshme, 01. nr.110 - 31584, të dt. 30.8.2012.

Neni 24

Kjo rregullore hyn në fuqi pas certifikimit të saj nga Ministria e Financave.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr. 110 - 230158, më 3.10.2014

KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi, jur. i dipl.

A r s y e t i m

Me qëllim të zbatimit të Ligjit nr. 03/L - 2004, për tatimin në pronën e paluajtshme, Kuvendi i Komunës, më 29.9.2011, ka miratuar Rregulloren për tatimin në pronën e paluajtshme. Rregullorja mban nr. të protokollit 01. nr. 110 - 2250.

Kuvendi i Republikës së Kosovës, ka miratuar Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L - 204, për tatimin në pronën e paluajtshme. Ky ligj mban numrin 04/L - 100, dhe është publikuar në "Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës, nr. 14/2012.

Qëllimi i këtij ligji ka qenë ndryshimi i normës në pagesën e tatimit në pronën e paluajtshme dhe i procedurës së ankimit.

- Shkalla e tatimit është kërkuar të jetë prej zero pikë pesëmbdhjetë për qind (0.15%) deri në një për qind (1%) të vlerës së pronës në treg.
- Sipas dispozitave të nenit 4 të ligjit të cekur, është paraparë edhe kronologjia e procedurës së ankimit nga ana e tatimpaguesve, të cilët nuk pajtohen me vendimin e lëshuar nga Bordi komunal për ankesa.

Për të zbatuar këto ndryshime, Kuvendi i Komunës, më 30.8.2012, ka miratuar Vendimin 01. nr. 110 - 31584.

Pasi Komisioni për emërtimin e rrugëve, ka kryer punën e tij dhe, duke pasur parasysh obligimet që ka Komuna për miratimin e kësaj rregulloreje për zbatim në vitin 2015, është propozuar që Kuvendit të Komunës t'i PROPOZOHET për miratim Rregullorja më përmbajtjen e cekur më lart.